



Misioni ndërkombëtar i ENEMO-së për vëzhgimin e zgjedhjeve

Zgjedhjet lokale në Kosovë 2013 – Raundi i dytë i zgjedhjeve lokale

Deklarata e gjetjeve dhe përfundimeve paraprake

Raundi i dytë i zgjedhjeve për kryetarë të komunave në Republikën e Kosovës ka përmbushur shumë standarde ndërkombëtare për zgjedhje demokratike, ndonëse disa çështje të identifikuar që në raundin e parë të zgjedhjeve shkaktojnë brengosje, siç është keqpërdorimi i burimeve shtetërore, blerja e votave, votimi familjar dhe dhuna në disa vendvotime.

Në vijim të ftesës nga Presidentja e Republikës së Kosovës, zonja Atifete Jahjaga, Rrjeti Evropian i Organizatave për Vëzhgimin e Zgjedhjeve (ENEMO) e ka vendosur Misionin për vëzhgimin e zgjedhjeve (MVZ) për t'i vëzhguar Zgjedhjet lokale në Kosovë më 3 nëntor 2013, si dhe përsëritjen e raundit të parë në Mitrovicën e Veriut dhe raundin e dytë të zgjedhjeve lokale më 1 dhjetor.

Procesi zgjedhor vlerësohet në bazë të standardeve ndërkombëtare për zgjedhje demokratike dhe legjislacionit kombëtar. Misioni ndërkombëtar vëzhgues i ENEMO-s e ka vëzhguar procesin zgjedhor në Kosovë që nga fillimi i tetorit të vitit 2013. 12 vëzhgues afatgjatë e kanë mbuluar tërë territorin e Kosovës me 6 ekipe duke e vëzhguar klimën para-zgjedhore, përfshirë edhe fushatën politike dhe aktivitetet e administratës zgjedhore para zgjedhjeve të 3 nëntorit. Aktivitetet e njëjta janë vëzhguar edhe në periudhën para 1 dhjetorit, kur është mbajtur raundi i dytë i zgjedhjeve lokale. ENEMO e ka publikuar deklaratën e parë paraprake më 5 nëntor 2013. Më 19 nëntor është lëshuar një deklaratë tjetër për përsëritjen e votimeve në Mitrovicën e Veriut (të dy dokumentet gjenden në www.enemo.eu). Deklarata në vijim e pasqyron vëzhgimin e raundit të dytë të zgjedhjeve për kryetarë të komunave më 1 dhjetor, si dhe ditës e zgjedhjeve.

Kjo deklaratë paraprake është vazhdimësi e gjetjeve dhe përfundimeve nga 2 deklaratat paraprake, të publikuara nga ENEMO për zgjedhjet lokale të vitit 2013 në Kosovë. Së këndejmi, ky raport nuk i përsërit gjetjet kryesore që tashmë janë cekur në dy deklaratat paraprake dhe në vend të kësaj, raporti përqendrohet në aspektet specifike për raundin e dytë. Në këtë drejtim, shumica e gjetjeve për kornizën zgjedhore, organet e menaxhimit zgjedhor, regjistrimin e votuesve dhe listat e votuesve mbesin të njëjta si edhe gjetjet e publikuara në deklaratën e parë paraprake për zgjedhjet lokale në Kosovë në vitin 2013.

Në ditën e votimit për raundin e dytë të zgjedhjeve lokale, ENEMO ka dërguar 28 vëzhgues nga organizatat-anëtare, të cilat e kanë vëzhguar procesin në 155 vendvotime në 25 komunat e mbetura në Kosovë, përfshirë edhe votimin e përsëritur në 3 vendvotime në Zveçan. Këto gjetje dhe përfundime janë paraprake dhe nuk japin vlerësim përfundimtar për tërë procesin zgjedhor. Misioni do të mbetet në Kosovë për ta vëzhguar edhe procesin e numërimit dhe auditimit dhe do të publikojë një raport përfundimtar në fund të janarit 2014.

PËRFUNDIMET PARAPRAKE

Raundi i dytë i zgjedhjeve lokale në Kosovë është realizuar në mënyrë efikase nga autoritetet përgjegjëse për menaxhimin e zgjedhjeve.

Dita e zgjedhjeve ka qenë e qetë dhe i ka pasqyruar përmirësimet e mëtejshme të realizimit të votimit dhe numërimit dhe mbylljes nga KVV-të, pavarësisht disa rasteve të regjistruara të dhunës në vendvotime.

Vëzhguesit e ENEMO-s e kanë vërejtur keqpërdorimin e burimeve/fuqisë edhe në raundin e dytë, në pjesën më të madhe të komunave. Janë raportuar disa raste kur zyrtarë të ndryshëm publikë kanë ushtruar presion dhe kërcënime mbi qytetarët për të votuar për kandidatë të caktuar. Bashkëbiseduesit e ENEMO-s kanë deklaruar se shumica e kërcënimeve i është drejtuar shfrytëzuesve të ndihmës sociale dhe nëpunësve publikë.

Vëzhguesve të ENEMO-s dhe mediave i janë raportuar disa raste të blerjes së pretenduar të votave.

KQZ dhe Sekretariati i KQZ-së e ka kryer punën në mënyrë profesionale në pjesën më të madhe të aktiviteteve zgjedhore.

Ndonëse periudha zyrtare për fushatën politike për raundin e dytë ka qenë e shkurtër, në praktikë ajo asnjëherë nuk është ndalur pas raundit të parë, duke u përqendruar në fushatën derë më derë nga shumica e subjekteve politike, të cilat i mbështesin kandidatët për kryetarë komunalë.

Në disa komuna është vërejtur fushata negative – në masë më të madhe në Gjakovë dhe Shtërpcë. Njëherazi, mungesa e rregullave adekuate ka krijuar hapësirë për rritje të fushatës negative në internet dhe veçanërisht përmes rrjeteve sociale.

Sjellja e anëtarëve të KVV-ve është përmirësuar dukshëm, krahasuar me raundin e parë zgjedhor, veçanërisht në aspekt të paketimit të materialeve.

Për dallim nga raundi i parë, vëzhguesit e ENEMO-s nuk kanë vërejtur raste kur votuesit nuk janë lejuar të votojnë me dokumente identifikimi që nuk janë dokumente kosovare.

Sa i përket barazisë gjinore, si edhe në raundin paraprak zgjedhor, institucionet nuk kanë siguruar përfaqësim adekuat të gjinisë me përfaqësim më të ulët në të gjitha nivelet e administrimit zgjedhor.

Në bazë të raporteve të vëzhguesve, votimi familjar ka qenë sfidë për shumë vendvotime.

ENEMO dëshiron ta përgëzojë Policinë dhe Zyrat e Prokurorëve të Kosovës, për efikasitetin e tyre në procesimin e të gjitha rasteve të pretenduara të mashtrimeve, keqpërdorimeve dhe dhunës zgjedhore. ENEMO sërish i nxitë institucionet gjyqësore që ta vazhdojnë procesimin e të gjitha rasteve të mashtrimeve dhe keqpërdorimeve zgjedhore, në mënyrë profesionale, të menjëhershme dhe transparente.

Të gjitha KKZ-të kanë realizuar trajnime shtesë për KVV-të, ku janë trajtuar disa prej parregullsive procedurale që janë vërejtur nga ENEMO në raundin e parë zgjedhor, përfshirë edhe mbushjen e formularëve të rezultateve, si dhe paketimin joadekuat të materialeve.

ENEMO i rekomandon fuqishëm të gjitha institucioneve zgjedhore që ta rrisin efikasitetin dhe transparencën e punës në zgjedhjet e ardhshme, veçanërisht në fushën e rezultateve zgjedhore, listave të votuesve, vendimeve të KQZ-së dhe PZAP-it, si dhe punës së QNR-së. Ueb-faqja e KQZ-së duhet të përditësohet më rregullisht dhe KQZ duhet t'ia shpjegojë më mirë qytetarëve dhe subjekteve politike që rezultatet e shpallura në K-Vote nuk janë rezultate zyrtare të zgjedhjeve.

GJETJET PARAPRAKE

Konteksti

Zgjedhjet lokale për kryetarë dhe kuvende komunale të vitit 2013 janë zgjedhjet e dyta të nivelit lokal që organizohen nga autoritetet e Republikës së Kosovës, si dhe të parat që organizohen nga autoritetet e Kosovës në mbarë territorin e shtetit¹.

Zgjedhjet janë mbajtur pas arritjes së “Marrëveshjes së parë të parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve” nga autoritetet e Prishtinës dhe Beogradit, me lehtësimin nga Bashkimi Evropian. Ky dokument është bërë pikënisje për integrimin e komunave në veriun e Kosovës me shumicë serbe. Dokumenti e prezanton modelin e autonomisë për komunat me shumicë serbe, duke i dhënë edhe garanci tjera institucionale pakicës serbe.

Në raundin e parë të zgjedhjeve janë zgjedhur 12 kryetarë komunash me shumicën e nevojshme. Raundi i dytë i zgjedhjeve për kryetarë komunalë është shpallur në 25 komuna, mes dy kandidatëve me shumicën e votave. Votimi i raundit të parë zgjedhor është përsëritur në 3 vendvotime në Zveçan.

Kështu, përveç Zveçanit ku është mbajtur raundi i parë, me vetëm dy kandidatë për kryetar komune, 50 kandidatët e tjerë patën mundësinë të garojnë për pozitën e kryetarëve të komunave në raundin e dytë zgjedhor. Vetëm një kandidat i ka takuar gjinisë femërore.

Prej 12 kryetarëve komunalë të zgjedhur në raundin e parë, 4 e përfaqësojnë PDK-në qeverisëse, 3 LDK-në, 2 janë nga GIS, ndërsa 1 kryetar komune është zgjedhur nga AAK-LDD dhe Kosova Turk Adalet Partisi. Rufki Suma ka qenë kryetari i vetëm komunal i zgjedhur si kandidat i pavarur. Prej 9 kandidateve që kanë garuar për kryetar komune në raundin e parë, vetëm njëra është kualifikuar për raundin e dytë (kandidatja e AKR-së në Gjakovë).

Në raundin e dytë të zgjedhjeve, LDK ka pasur 14 kandidatë për kryetarë komunalë, PDK 11, AAK-LDD 8, GIS 7, SLS 3, AKR 2, LVV 1, IQM 1, SKS 1, SNP 1 dhe GI SDP 1. Gjendja në Zveçan edhe më tej mbetet pezull, meqë raundi i parë nuk është përfunduar për shkak të votimit të përsëritur në tre vendvotime, që është mbajtur paralelisht me raundin e dytë në të gjitha komunat tjera.

¹ Procesi zgjedhor në 4 komuna në veriun e Kosovës lehtësohet nga OSBE.

Korniza ligjore dhe sistemi zgjedhor

Raundi i dytë i zgjedhjeve lokale është mbajtur në pajtim me kornizën ligjore zgjedhore të Kosovës, që përbëhet nga Kushtetuta e Kosovës, disa ligje mbi zgjedhjet², aktet nënligjore të miratuara pas shpalljes së pavarësisë më 17 shkurt 2008, si dhe rregullativat e KQZ-së të miratuara në vitin 2013. Zgjedhjet lokale në Kosovë për kuvendet komunale dhe kryetarët e komunave mbahen çdo katër vite. Kryetarët e komunave zgjidhen në bazë të sistemit të shumicës prej dy raundeve dhe për të fituar, kandidatët duhet ta fitojnë shumicën absolute në raundin e parë. Në rastet kur asnjë kandidat nuk fiton më shumë se 50% plus 1 votë të numrit të përgjithshëm të votave të vlefshme të hedhura në raundin e parë, kalohet në raundin e dytë që mbahet katër javë pas raundit të parë, për dy kandidatët që kanë fituar më shumë vota në raundin e parë.

Votuesit të cilët banojnë jashtë Kosovës kanë pasur të drejtë të votës përmes postës për dy raundet zgjedhore, me kusht që t'i përmbushin të gjitha kërkesat ligjore.

Administrimi zgjedhor

Administrimi zgjedhor në Kosovë përbëhet prej sistemit tre-shkallor: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), Komisionet komunale të zgjedhjeve (KKZ), si dhe Qendrat e votimit/Këshillat e vendvotimeve (QV/KVV).

Pavarësisht të gjitha mangësive të dispozitave ligjore të Kosovës për administrimin zgjedhor, që cekën në raportin paraprak të ENEMO-s për raundin e parë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve përfshirë edhe Sekretariatit e KQZ-së i ka organizuar të gjitha aktivitetet administrative zgjedhore për raundin e dytë në mënyrë efikase dhe profesionale. Gjatë raundit të dytë, KQZ ka realizuar trajnime plotësuese për anëtarët e KVV-ve, në bashkëpunim me KKZ-të. Përveç kësaj, KKZ e ka aplikuar sërish K-Vote 2013 si një mjet pozitiv të mbështetjes, që ka qenë burimi i vetëm zyrtar i rezultateve paraprake zgjedhore në raundin e parë, ndonëse nuk ka qenë tërësisht i saktë dhe i besueshëm.

Në raundin e parë zgjedhor është dëshmuar që Sekretariati i KQZ-së dhe KKZ-të nuk kanë pasur sukses në përzgjedhjen e anëtarëve adekuatë të KVV-ve në mbarë Kosovën, ose që trajnime për KVV-të nuk ka qenë adekuat, meqë mbi 500 kuti votimi janë mbajtur në karantinë nga QNR për shkak të të dhënave të pavijueshme mes formularëve të hapjes dhe mbylljes, ose paketimit joadekuat të materialeve pas mbylljes së vendvotimeve. Ky numër e pasqyron pothuajse ¼ e të gjitha vendvotimeve në Kosovë. Shumica e këtyre kutive është dashur të auditohet, disa madje edhe të rinumërohen, kryesisht për shkak të pakujdesisë dhe/ose mungesës së profesionalizmit dhe njohjes së procedurave nga anëtarët e KV-ve.

Për raundin e dytë zgjedhor janë zëvendësuar 743 komisionerë të vendvotimeve (përfshirë edhe zëvendësuesit), ndërkohë që përpjekjet e Sekretariatit të KQZ-së dhe KKZ-ve janë orientuar kryesisht drejt sigurimit të trajnimeve plotësuese KVV, veçanërisht për problemet dhe të metat kryesore që janë vërejtur në

² Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 03/I-073 për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, Ligji Nr. 03/I-256 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/I-073 për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, si dhe Ligji 03/I-072 për zgjedhjet lokale në Republikën e Kosovës.

raundin e parë zgjedhor (formularët e të dhënave dhe rezultateve, si dhe paketimi i materialeve zgjedhore). ENEMO edhe më tej do ta vëzhgojë verifikimin dhe auditimin e materialeve të vendotimeve në QNR, për të përcaktuar nëse Sekretariati i KQZ-së e ka përmirësuar efikasitetin dhe profesionalizmin e punës së KVV-ve përmes trajnimeve plotësuese. Deri tani, në bazë të të dhënave nga vëzhguesit afatshkurtër në ditën e votimit, janë vërejtur përmirësime të dukshme në punën e KVV-ve në mbarë Kosovën.

Regjistrimi i kandidatëve

Në raundin e parë të zgjedhjeve lokale janë certifikuar gjithsej 103 subjekte politike për zgjedhje (33 parti politike, 52 iniciativa qytetare, 16 kandidatë të pavarur dhe 2 koalicione) me gjithsej 7.932 kandidatë. Përveç kësaj, për pjesëmarrje në zgjedhje janë regjistruar edhe 224 kandidatë për kryetarë komunash. Vetëm 9 prej tyre kanë qenë femra.

Meqë 12 kryetarë janë zgjedhur që në raundin e parë, në raundin e dytë të zgjedhjeve për kryetarë të komunave kanë garuar 50 kandidatë në 25 komunitat e mbetura. Situata është disi më ndryshe në zgjedhjet e përsëritura në tre Qendra Votimi në Zvečan, ku do të zgjidhet kryetari i komunës që në këtë raund, pasi që aty garonin vetëm dy kandidatë për kryetar komune.

Regjistrimi i votuesve

Sipas KQZ-së, në komunitat ku është zhvilluar raundi i dytë i zgjedhjeve lokale në Kosovë, ka pasur gjithsej 1.371.524 votues të regjistruar. KQZ ia ka aprovuar 11.738 votuesve jashtë Kosovës të drejtën e votës në raundin e dytë të zgjedhjeve lokale përmes postës. Me sa duket, më pak se gjysma e kanë shfrytëzuar këtë të drejtë në raundin e dytë.

Edhe më tej mbeten problemet me Listën e Votuesve, që janë cekur në raportin e parë paraprak të ENEMO-s për zgjedhjet lokale 2013. Nuk janë raportuar ndryshime në Listën Përfundimtare të Votuesve mes dy raundeve zgjedhore. Së këndejmi, në pjesën më të madhe të komunave, dalja mesatare e votuesve³ në raundin e dytë ka qenë mes 39% dhe 45%. Dalja më e lartë është regjistruar në Partesh (62.81%), ndërkohë që dalje relativisht të lartë ka pasur edhe në Ranillug (56.74%), Kllokot (57.63%), Novobërdë (57.09%) si dhe Lipjan (53.65%). Dalje e ulët është regjistruar në Klinë (21.57%) dhe Mitrovicë të Veriut (17.26%), ndërsa dalje më e ulët se mesatarja është shënuar në Prizren (33.70%), Mitrovicë të Jugut (33.21%), Dragash (30,45%) dhe Vushtrri (28.14%)

Fushata

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ)⁴ ka vendosur më 20 nëntor që fushata zgjedhore për raundin e dytë të kufizohet në një periudhë pesëditore, prej datës 25 deri më 29 nëntor. Në pjesën e dytë të fushatës, pas raundit të parë zgjedhor, pjesa më e madhe e aktiviteteve politike është përqendruar në formimin e aleancave mes partive politike që i mbështesin kryetarët e komunave në komunitat të ndryshme. Shumica e

³ <http://rezultatet.rks-gov.net/NightResults/Results.aspx?RaceID=1&UnitID=1&IsPS=0&Turnout=3&LangID=2>

⁴ <http://www.kqz-ks.org/>

aleancave e kanë synuar përfitimin e mbështetjes nga kandidatët të cilët nuk janë më pjesë e garës. Udhëheqësit partiakë kanë udhëtuar anembanë Kosovës për t'i mbështetur kandidatët e tyre në tubime dhe takime të tjera. Shumica e kandidatëve janë përqendruar në fushatën derë më derë, duke krijuar kontakt të drejtpërdrejtë me qytetarët.

Ndonëse fushata publike ka qenë kryesisht e qetë dhe pa incidente të mëdha, në disa komuna është vërejtur fushatë negative, veçanërisht gjatë debateve dhe tubimeve politike. Vëzhguesit afatgjatë të ENEMO-s kanë vërejtur disa raste të fushatës negative para raundit të dytë – veçanërisht në Gjakovë dhe Shtërpçë. Përveç kësaj, pjesa më e madhe e fushatës negative dhe ofendimeve mes kandidatëve për kryetarë të komunave ka ndodhur në internet dhe në rrjetet sociale, blog-faqet, etj. Fakti që fushata politike në internet nuk rregullohet në masë adekuate me ligj dhe nuk mbikëqyret nga KPM ose ndonjë institucion tjetër shtetëror, ka krijuar hapësirë për keqpërdorime të fuqishme të këtij mediumi, si dhe për ushtrim potencial të ndikimit mbi votuesit, veçanërisht mbi të rinjtë të cilët e përdorin internetin mjaft shpesh dhe i përcjellin rregullisht rrjetet sociale.

Ankesat dhe parashtrës

Legjislacioni zgjedhor siguron mekanizma mbrojtës për mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve, si dhe të drejtave të subjekteve politike. Ankesat dhe parashtrës mund t'i parashtrihen gjykatës së shkallës së parë, si dhe Komisionit zgjedhor për ankesa dhe parashtrës (PZAP). PZAP është trup i pavarur, përgjegjës për vendim-marrje mbi ankesat dhe parashtrës që kanë të bëjnë me procesin zgjedhor.

Siç parashihet në Nenin 9 të Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme, votuesit me të drejtë vote mund t'i sfidojnë pasaktësitë ose lëshimet në Listën e votuesve. Vendimet e lidhura me ndryshimin e Listës së votuesve merren nga gjykata e shkallës së parë, në pajtim me rregullat e KQZ-së. Përveç kësaj, ankesat që kanë të bëjnë me numërimin në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), mund t'i parashtrihen PZAP-it brenda 24 orëve nga momenti kur ndodh shkelja e pretenduar. Por, ankesa e dorëzuar nuk e pengon ose suspendon procesin e numërimit. Për të gjitha ankesat e parashtrëura në PZAP duhet të merret vendim i menjëhershëm, jo më vonë se 72 orë nga pranimi i ankesës në zyrat qendrore të PZAP-it.

Gjatë periudhës zgjedhore, PZAP ka pranuar gjithsej 774 ankesa për dy raundet, pa i marrë parasysh parashtrës për votimin e votuesve jashtë Kosovës. Prej ankesave të pranuar, 274 kanë të bëjnë me fushatën e raundit të parë, që ceken në Raportin e parë paraprak të ENEMO-së. Përveç kësaj, janë dorëzuar edhe 173 ankesa tjera për ditën e votimit në raundin e parë (11 janë aprovuar, 154 janë refuzuar dhe tjerat janë hedhur poshtë, tërhequr ose janë shpallur të pavlefshme). PZAP-it i janë dorëzuar edhe 261 ankesa për procesin e numërimit, si dhe 61 ankesa për rezultatet paraprake të KQZ-së (kryesisht K-vote). Pjesa më e madhe e ankesave janë refuzuar për shkak të mungesës së dëshmive ose për arsye se kanë qenë të pavlefshme, të vonuara dhe parregullta. Disa prej tyre janë tërhequr. PZAP ka pranuar vetëm dy ankesa të lidhura me procesin e numërimit, njëra prej të cilave ka rezultuar me përsëritje të votimit në Mitrovicën e Veriut. Njëherazi, PZAP ia ka dorëzuar policisë 36 ankesa, meqë mund të përfshijnë sanksione të mundshme penale.

Media

Gjatë Zgjedhjeve lokale 2013, MVZ ENEMO nuk ka realizuar vëzhgim të plotë të mediave. Për këtë arsye, të gjitha komentet në këtë pjesë bazohen në vështrimet dhe intervistat me aktorët e mediave, si dhe i referohen Komisionit të pavarur të mediave (KPM) dhe raporteve të këtij Komisioni për vëzhgimin e mediave gjatë fushatës zgjedhore.

Shumica e mediave kosovare e kanë mbuluar fushatën zgjedhore për raundin e dytë përmes edicioneve informative, debateve televizive, si dhe reklamave politike. Janë organizuar disa debate në stacionet televizive nacionale dhe lokale, ku prania e vetëm dy kandidatëve për raundin e dytë e ka lehtësuar vendim-marrjen e votuesve. Krahasuar me komunat tjera, mediat i kanë përkushtuar vëmendje të veçantë fushatës në Prishtinë, ndonëse edhe tjerat janë mbuluar rregullisht.

Komisioni i pavarur i mediave (KPM)⁵ ka qenë përgjegjës për mbikëqyrjen e mediave edhe gjatë raundit të dytë. Sipas burimeve në KPM, mbikëqyrja e mediave tregon që ndonëse ka pasur disa shkelje të vogla, mediat kanë raportuar kryesisht në mënyrë të drejtë dhe paanshme. Deri tani, KPM-së i është parashtruar 1 ankesë zyrtare, lidhur me shkeljen e heshtjes parazgjedhore të 1 mediumi gjatë raundit të dytë.

KPM duhet t'i publikojë rregullisht të gjitha raportet në ueb-faqen e saj, në bazë të mbikëqyrjes së realizuar. Megjithatë, që nga raporti i parë javor, i publikuar më 16 tetor, në ueb-faqen e KPM-së nuk është shpallur asnjë raport tjetër ose përcjellje e vijimit të fushatës. Sipas KPM-së, janë parashtruar 10 ankesa zyrtare për sjelljen e mediave në raundin e parë të zgjedhjeve lokale. KPM nuk ka ndërmarrë asnjë veprim zyrtar lidhur me ankesat e parashtruara.

Gazetat ditore janë përfshirë në fushatë me shkrime të ndryshme, si dhe intervista gjatë fushatës. Ndonëse për mediat e shkruara nuk ka rregullator shtetëror i cili ushtron mbikëqyrje, gazetatat kryesore e kanë themeluar Këshillin e mediave të shkruara, që vepron si trup vetë-rregullues për mediat e shkruara.

Kandidatët i kanë shfrytëzuar edhe rrjetet sociale (Facebook, Twitter, etj) për kontakt të drejtpërdrejtë me mbështetësit e tyre, por edhe për të ushtruar aspekte të caktuara të fushatës negative ndaj kundërshtarëve.

Dita e zgjedhjeve

Në shumicën e vendvotimeve të vizituara nga vëzhguesit e ENEMO-së, procesi zgjedhor në ditën e zgjedhjeve është realizuar në mënyrë profesionale dhe të qetë. Megjithatë, janë raportuar disa raste të dhunës, ku rasti më serioz ka ndodhur në Pasjanë (Komuna Partesh), në vendvotimin ku vëzhguesit afatshkurtër të ENEMO-së e kanë vëzhguar mbylljen dhe numërimin e një vendvotimi (3603d/02r). Pas numërimit të të gjitha votave në këtë vendvotim dhe në periudhën kur KVV i ka plotësuar formularët e mbylljes (rreth orës 20:20), një grup prej 20 personave është futur në këtë vendvotim dhe ka filluar t'i shkatërrojë materialet zgjedhore. KVV e ka rrezikuar integritetin fizik duke tentuar t'i mbrojë fletëvotimet dhe materialet tjera nga sulmuesit. Dhuna është përshkallëzuar dhe ka ndodhur një rrahje mes personave në

⁵ <http://kpm-ks.org/>

vendvotim dhe grupit të sulmuesve. Policia ka arritur shpejtë pas incidentit, kur shumica e materialeve kanë qenë të shkatërruara dhe disa persona kanë qenë të lënduar.

ENEMO dëshiron ta lavdërojë profesionalizmin dhe përkushtimin e anëtarëve të KVV-së të cilët e kanë rrezikuar integritetin e tyre fizik, për t'i mbrojtur materialet zgjedhore dhe kutitë e votimit.

Megjithatë, disa shkelje procedurale të vërejtura në raundin e parë zgjedhor janë vërejtur sërish nga vëzhguesit afatshkurtër, të cilët i kanë vizituar vendvotimet në raundin e dytë. Çështja kryesore edhe më tej mbetet votimi familjar, që ka ndodhur në 17% të vendvotimeve të vizituara. Në një vendvotim ka pasur 7 raste të votimit familjar brenda 20 minutave, në periudhën kur kanë qenë të pranishëm vëzhguesit tonë. Në 5% të vendvotimeve të vizituara është shënuar votimi me ndërmjetësim. Këto dy lloje të shkeljeve janë vërejtur në vëllim të njëjtë si edhe gjatë raundit të parë.

Në këtë raund zgjedhor nuk janë vërejtur problemet e shënuara në raundin e parë, që kanë të bëjnë me mungesën e profesionalizmit dhe trajnimit të komisionerëve të vendvotimeve, veçanërisht në aspekt të paketimit të materialeve dhe shënimit të të dhënave në formularë. Në fakt, sjellja dhe profesionalizmi i anëtarëve të KVV-ve është përmirësuar dukshëm në krahasim me raundin e parë zgjedhor në pjesën më të madhe të komunave të vëzhguara.

Një shkelje tjetër e Ligjit që është vërejtur nga ekipet e vëzhguesve afatshkurtër të ENEMO-s ka qenë vendosja e materialeve të fushatës së disa subjekteve politike, në afërsi më të vogël se 100 metra nga vendvotimet (VV). Rastet e këtilla janë vërejtur nga vëzhguesit e ENEMO-s në 6% të VV-ve të vizituara në raundin e dytë. Krahasuar me raundin e parë zgjedhor, kur shkeljet e këtilla janë vërejtur në 16% të vendvotimeve të vizituara, është e qartë që në këtë fushë është shënuar një përmirësim i caktuar.

Ka pasur disa raste kur votuesit janë lejuar të votojnë pa dokument identifikimi, ku arsyeja kryesore ka qenë që anëtari i KVV-së e ka njohur votuesin dhe andaj nuk është nevojitur të tregohet asnjë dokument identifikimi për të votuar. Në një vendvotim në Shtërpcë, në periudhën kur kanë qenë të pranishëm vëzhguesit tanë, është lejuar votimi i 16 votuesve pa dokument identifikimi.

Një dukuri e përbashkët është që pothuajse në të gjitha vendvotimet, numri i fletëvotimeve të pranuar nga KVV ka qenë më i ulët se numri i votuesve të regjistruar në Listën përfundimtare të votuesve për vendvotimin përkatës.

Vëzhguesit e ENEMO-s kanë raportuar për një numër të madh të votuesve të cilët kanë kërkuar ndihmë dhe kanë votuar me ndihmë nga personat tjerë. Disa bashkëbisedues të ENEMO-s kanë konfirmuar që kjo metodë shfrytëzohet nga subjektet e caktuara politike si mekanizëm për sigurimin e votave, si dhe që disa prej personave që ofrojnë ndihmë të këtillë janë përfaqësues partiakë, ku shumica e votuesve të cekur nuk kanë asnjë nevojë reale për ndihmë.

59% e vendvotimeve të vëzhguara nuk kanë qenë të kapshme për personat me paaftësi, që është një rritje prej 6% krahasuar me raundin e parë zgjedhor, ku 53% e vendvotimeve të vizituara nuk kanë qenë adekuate për personat me paaftësi.

Vetëm në disa vendvotime, votuesit që votojnë në shtëpi kanë qenë të nënvizuar në Listën e votuesve.

Barazia gjinore mes anëtarëve të KVV-ve ka qenë joadekuate, meqë shumica e KVV-ve është përbërë nga meshkujt.

Në përgjithësi, vendotimet e vëzhguara janë vlerësuar shumë pozitivisht nga ekipet e vëzhguesve afatshkurtër të ENEMO-s. 47% e vendotimeve janë vlerësuar me shumë mirë, 48% mirë dhe 5% janë vlerësuar si jo të mira.

Misionet për vëzhgimin e zgjedhjeve

Për raundin e dytë të zgjedhjeve, KQZ ka akredituar 2.284 vëzhgues shtesë, përveç 30.173 vëzhguesve tashmë të akredituar për raundin e parë, ku janë përfshirë përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, organizatave ndërkombëtare, ambasadave të huaja, subjekteve politike, koalicioneve dhe kandidatëve të pavarur, iniciativave qytetare dhe mediave. Organizatat e shoqërisë civile i kanë vazhduar aktivitetet e tyre për vëzhgimin e zgjedhjeve. Koalicioni “Demokracia në Veprim” (DnV) e ka vëzhguar tërë procesin zgjedhor dhe ka dërguar vëzhgues anëmbanë Kosovës në ditën e zgjedhjeve. Vëzhguesit e DnV-së e kanë vëzhguar votimin e raundit të dytë në të gjitha 25 komunat. Vëzhguesit afatshkurtër të ENEMO-së kanë vërejtur vëzhgues vendas jopartiakë në 74% të vendotimeve të vizituara në raundin e dytë.

Për raundin e dytë, Misioni i Bashkimit Evropian ka dërguar 71 vëzhgues afatshkurtër në ditën e votimit në të gjitha 25 komunat. Vëzhgues të akredituar për zgjedhjet lokale kanë pasur edhe Instituti Nacional Demokratik (NDI) dhe disa ambasada, si pjesë e angazhimit të rregullt politik në Kosovë. NDI ka pasur 7 ekipe në terren, ndërkohë që vëzhgues tjerë janë akredituar si pjesë e disa ambasadave të pranishme në Kosovë, si për shembull Ambasada e Shteteve të Bashkuara, Ambasada e Britanisë, Ambasada e Turqisë, Ambasada e Francës e të tjera.

Pjesëmarrja e femrave

Korniza ligjore e Kosovës e promovon barazinë gjinore në tërë Kushtetutën si “vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë”, si dhe në Ligjin për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, ku në kuadër të parimeve themelore përcaktohet që të gjitha subjektet politike dhe trupat zgjedhorë obligohen t’i respektojnë kërkesat për kuota gjinore siç përcaktohen nga ky ligj.

Prej gjithsej nëntë kandidateve në raundin e parë, vetëm njëra prej tyre garoi në raundin e dytë për pozitën e kryetarit të komunës, atë të Gjakovës. Sipas rezultateve paraprake të KQZ-së, Kosova do të ketë 1 kryetar komune, pikërisht në këtë qytet.

Sa i përket barazisë gjinore në trupat e administrimit zgjedhor, gjendja ishte e ngjashme me raundin e parë të zgjedhjeve, kur pjesëmarrja e femrave ishte e ulët. Në Komisionet komunale, si dhe në Këshillat e vendotimeve, femrat nuk kanë qenë të përfaqësuara siç parashihet me Ligjin për barazi gjinore, ku përcaktohet që gjinia me përfaqësim më të ulët duhet të jetë e përfaqësuar me të paktën 40%. Megjithatë, barazia gjinore është respektuar gjatë përsëritjes së votimit në Mitrovicën e veriut më 17 nëntor.

Informatat për Misionin dhe Mirënjohjet

Rrjeti evropian i organizatave për vëzhgimin e zgjedhjeve (ENEMO) është grup i 22 organizatave udhëheqëse qytetare prej 17 shteteve të Evropës lindore dhe qendrore, si dhe Azisë qendrore. Organizatat-anëtare të ENEMO-së kanë vëzhguar mbi 140 zgjedhje nacionale dhe kanë trajnuar mbi 200.000 vëzhgues.

ENEMO e synon përkrahjen e interesave të bashkësisë ndërkombëtare në promovimin e demokracisë në rajonin ku angazhohet, për vlerësimin e proceseve zgjedhore dhe klimës politike dhe sigurimin e raporteve të sakta dhe të paanshme të vëzhgimit. Misionet ndërkombëtare të vëzhgimit të ENEMO-s e vlerësojnë procesin zgjedhor duke i aplikuar standardet ndërkombëtare për zgjedhje demokratike dhe kriteret e legjislacionit dhe kushtetutës së shtetit të vlerësuar.

Për këtë Mision vëzhgues të zgjedhjeve, vëzhguesit kanë ardhur nga 7 shtete të ndryshme, **anëtarë të ENEMO-së**. Raporti paraprak i vëzhgimit të ENEMO-së bazohet në vëzhgimet e vëzhguesve afatgjatë dhe afatshkurtër, si dhe gjetjeve të tyre lidhur me standardet ndërkombëtare dhe legjislacionin zgjedhor nacional. Misioni sërish thekson që ky raport paraprak nuk jep vlerësim përfundimtar të mbarë procesit zgjedhor. ENEMO do ta dorëzojë vlerësimin përfundimtar pas përfundimit të procesit zgjedhor, ku përfshihet numërimi i votave, shpallja e rezultateve, rivotimet e mundshme dhe ankesat potenciale që kanë të bëjnë me raundin e dytë.

Misioni ENEMO dëshiron t'ia shprehë falënderimin e saj Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për bashkëpunimin dhe ndihmën e dhënë gjatë vëzhgimit, si dhe të gjitha palëve tjera me të cilat ka bashkëpunuar ENEMO. ENEMO e shfrytëzon këtë mundësi për shprehjen e mirënjohjes më të lartë për përkrahjen nga donatorët e misionit vëzhgues – Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) përmes Institutit Nacional Demokratik (NDI), Ministrisë Federale për Punë të Jashtme të Gjermanisë përmes Ambasadës së Republikës Federale Gjermane në Prishtinë, si dhe Ambasadës së Dukës së Madh të Luksemburgut.

*Ky dokument publikohet në gjuhën shqipe dhe serbe,
por vetëm versioni në gjuhën angleze mbetet zyrtar.*

Për më tepër informata, ju lutemi kontaktoni:

Gazmend Agaj, Zyrtar për shtyp
Misioni për Vëzhgimin e Zgjedhjeve Lokale në Kosovë 2013
Adresa: rr. Hamzë Jashari nr.29, 10000 Prishtinë
Cel: +377 (0) 45 845 637
Email: gazmend.agaj@enemo.eu

